



Pranimi / Dorezimi Pranimi / Prodato Received / Delivery	08.11.2023	3	viti god year
Organ / Mësi Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	6939/2023		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1218/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1218/2023 të datës 28.09.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me numër Nr.40/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit të për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1218/2023 e datës 28.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.40/2023 i datës 19.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 34 paragrafi (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës fillimisht më datë 14.07.2023 ka njoftuar për konkursin me numër reference Nr.ref.RN00012073, për grupin “Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën e punës „Inspektor i Tregut në Prishtinë”, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ku afati për aplikim ka qenë nga data 04.08.2023 deri më datën 11.08.2023.



Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs me datë 07.08.2023 ka aplikuar edhe ankuesi me numër kodit RAN0016458. Më datë 08.09.2023 Divizioni për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.391/2023 përmes së cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas konkursit, gjegjësisht nuk ka dorëzuar vetë deklarin e nënshkruar se nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ne rastet kur përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda ose jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune.

Ankuesi kundër këtij Vendimi, më datë 11.09.2023 përmes portalit elektronik, ka parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik. Ndërsa më datë 19.09.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.40/2023 përmes së cilit ankuesit i është refuzuar ankesa si e papabuar.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.40/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 28.09.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 6288/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 05.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 16.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1708/2 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 6288/2023 të datës 28.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference Nr.RN00012073 të datës 04.08.2023; Vendimin me numër Nr.391/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Ankesën e datës 11.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në DMZP; Vendimin me numër Nr.40/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 16.10.2023; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 19.09.2023; Njoftimin e datës 11.09.2023; Vendimin me numër Nr.02/167 të datës 09.10.2023 për emërimin e anëtarve të komisionit të pranimit; Aplikacionin e datës 07.08.2023 me numër të referencës Nr.RN00012073; Diplomën me numër Nr.6318 të datës 12.06.2023 të lëshuar nga Fakulteti Juridik/Universiteti i Prishtinës; Certifikatën me numër reference Nr.328/22 të datës 30.01.2023 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve; Certifikatën me numër reference Nr.378/23 të datës 20.02.2023 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve; Certifikatën me numër reference Nr.414/23 të datës 13.05.2023 të lëshuar nga Qendra e Trajnimeve për Siguri dhe Shëndet në Punë; Vërtetimin të datës 17.01.2020 të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Vërtetimin për kryerejen e punës praktike prej datës 02.07.2019



deri më 21.02.2020 të lëshuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas; Kontratën e Punës me numër 876/20 të datës 10.06.2020; Aneks Kontratën e Punës me numër 3128/20 të datës 31.12.2020; Kontratën e Punës me numër Nr.2122/21 të datës 21.12.2021; Rekomendimin e datës 17.01.2020 të lëshuar nga Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas-Gjilan; Letërnjoftimin me numër 239306; Certifikatën mbi dënimet penale me numër Nr.ser. EA914FBBE710413 të lëshuar më datë 07.08.2023 Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë nga Trusti Pensional për periudhën kohore 18.07.2017 deri më 02.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën me numër protokollit 6288/2023 të datës 28.09.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.40/2023 të datës 19.09.2023 të nxjerrë nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, pretendon se pasi që nuk ka ushtruar asnjëherë pozitë të zyrtarit publik, sipas Ligjit Nr.06/L për Zyrtarët Publik, ka konsideruar se nuk është e nevojshme paraqitja e ndonjë vetë deklaramenti të nënshkruar që i njëjti nuk ka masë disiplinore në fuqi, si dhe kërkon nga Këshilli që ta shfuqizojë Vendimin me numër Nr.391/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se, kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër Nr.RN00012073 për emrin e grupit „Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm“, për pozitën e punës „Inspektor i Tregut në Prishtinë“, klasa e pozitës „Profesional 1“ në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Arsim i lartë i paspecifikuar;*
- *Kualifikime të posaçme formale;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë së punësimit të bashkangjitur së paku një dëshmi mbështetëse si në vijim: pasqyrën pagesave të fondit të kursimeve pensionale; kopjen e licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit; Dëshmi mjekësorë se kandidati është në gjendje shëndetësore për të kryer detyrat; Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një veprë penale me dashje jo me të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat*



*brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e Zyrtarëve Publikë të parapara me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila përcakton se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”.*

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit konstaton se në bazë të provave të cilat janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës, konkretisht dokumentacionin të cilin e ka dorëzuar ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se i njëjti nga data 17.05.2017 deri më 14.12.2017 në bazë të marrëveshjes për shërbime të veçanta ka punuar në pozitën e punës „Anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor për Komunën e Gjilanit,, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga data 02.07.2019 deri më 21.02.2020 ka punuar në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas në pozitën e „Praktikantit”, nga data 04.09.2019 deri më datën 12.12.2019 në bazë të marrëveshjes për shërbime të veçanta ka punuar në pozitën e punës „Anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor për Komunën e Gjilanit,, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa që nga data 01.06.2020 ankuesi vazhdon të jetë i punësuar në Zyrën e Përmbauesit Privat dhe mbanë pozitën e „Juristit”. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi, ka dorëzuar edhe dëshmi tjera për përvojën e punës me të cilat ka dëshmuar përvojën e punës, mirëpo nuk ka dorëzuar dëshmi apo vete deklaram të nënshkruar nga ai se nuk ka një mase disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i të gjitha provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguara nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale gjegjësisht nuk ka dorëzuar vetë deklaramin e nënshkruar nga ai se nuk ka mase disiplinore në fuqi ashtu siç është përcaktuar në konkurs, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me numër Nr.40/2023 i datës 19.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së



Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me Vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjerë të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, prandaj si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak se nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, sepse refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk është bërë për shkak të mos plotësimit të kriterëve në aspektin e përgatitjes profesionale apo në aspektin e mos përmbushjes së përvojës së punës por është bërë vetëm që nuk ka dorëzuar dëshminë e cekur si më lartë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1218/2023*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

*Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional*

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

*Kryetare e Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.